




REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 69/15

Nr. i fq. / Br. st - 2 -

Data: / Datum 26.03.2015

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

RREGULLORE
PËR KORRIGJIMN E RREGULLORES 01nr.20/15 dt.29.01.2015

MARS 2015

Bazuar në Nenin 12 paragrafi 2, pika “c” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Nenin 41 paragrafi 2, pika “c” të Statutit të Komunës, si dhe në Shkresën nr. 213/1, dt.26.02.2015 e Komisionit të Përbashkët MF-MAPL për shqyrtimin e ndryshimeve për Rregulloren nr.20/15, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **26 mars 2015**, miratoi këtë:

RREGULLORE
PËR KORRIGJIMIN E RREGULLORES 01NR.20/15, DT.29.01.2015

Neni 1

Me këtë Rregullore korrigjohet Rregullorja 01nr.20/15, dt.29.01.2015 duke e fshirë fjalën “KES/CO” nga paragrafi 1.12 lidhur me paragrafin 7.3, ndërsa pjesa tjetër e tekstit të këtij paragrafi mbetet e pandryshueshme.

Neni 2

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 3

Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje është Shkresa nr. 213/1, dt.26.02.2015 e Komisionit të Përbashkët MF-MAPL për shqyrtimin e ndryshimeve për Rregulloren nr.20/15.

Neni 4

Kjo Rregullore hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova


Kryesuesi i Kuvendit



PALESE-IZI AZNA-OUTGOIN
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVES VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Hr.
Gr.
No. 0203-150/3

Data
Datum
Data 02.03.2015



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 27.02.2015
Nr.0203-150/2

Për: Shpetim Zhegrova, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë

Lënda: Shkresë përcjellëse

I nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar **Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 01.Nr.330/12 të datës 27.12.2012 për Tarifa, Ngarkesa, dhe Gjoha Komunale**, e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë dhe nënshkruar nga Kryesuesi i KK të Vushtrrisë, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Në bazë të Vendimit të Qeverisë me Nr. 2/119 të datës 07.04.2010 për formimin e komisioneve për shqyrtimin e akteve lokale, MAPL, me shkresë përcjellëse të datës 05.02.2015, ka përcjellë aktet e lartshënuara te komisioni i përbashkët MF/MAPL, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni Raportin lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së rregullores të lartshënuar të Komunës së Vushtrrisë.

Me respekt,
Besnik Osmani,
Sekretar i Përgjithshëm,

*Kopje: Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë,
Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Arkivit të MAPL-së*

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije
 Ministry of Finance
 Arkivo - Arhiva - Archive

Nr. Org. 02c
 Nr. Prot. 213/1
 Nr. i listave 7
 Data e detyrimit 26.02.2015
 Datë: PRISHTINE/PL



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administration
 Ministry of Local Government Administration

Data: 26.02.2015

Për:	Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm, MAPL	
Cc:	Agron Maxhuni, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL	
Përmes:	Naim Baftiu Sekretari i Përgjithshëm, MF	
Nga:	Komisioni i përbashkët MF-MAPL 1. Lumnije Hetemi-kryesuese 2. Fetije Begolli -bashkë kryesuese 3. Driton Xhafa - antar 4. Jak Ndrecaj- antar 5. Bedrije Halili -antare	Data e Shqyrtimit: 24.02.2015
Lënda:	Shqyrtimi i ndryshimeve për e Rregulloren e komunën e Vushtrrisë me Nr.20/15	

I nderuar Sekretar,

Komisioni i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02-119 të datës 07.04.2010, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të komunave për kompetenca vetanake, dhe për kompetencat të deleguara dhe Rregullores Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, me datë 05/02/2015 ka pranuar Ndryshimet për Rregulloren e komunës së Vushtrrisë me Nr.20/15 për vlerësim të ligjshmërisë.

Komisionin pas vlerësimit të ligjshmërisë së Rregullores komunale ka konstatuar se:

Duhet komuna e Vushtrrisë ta përmirësoj nenin 1 piken 1.12 për arsye se në nen është specifikuar kompania e KES /CO kurse ligji Nr.03/L-049 për financat e pushtetit lokale neni 10 pika 4 nuk lejon që të vendoset taksa në bazë emërtimeve.

Bazuar në të cekurat më lartë Komisioni i përbashkët MF-MAPL, kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Vushtrrisë që të ndërmarrin veprime konkrete në përmirësimin e rekomanduar për, ndryshimet e Rregulloren e komunës së Vushtrrisë me Nr.20/15 kurse ndryshimet tjera janë në harmoni me legjislacionin në fuqi, dhe prodhon efekt të plotë juridik.

Me respekt,

Kryesuesja e Komisionit
 Lumnije Hetemi
Lumnije Hetemi